



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.111 dt.24.07.1998

**“PAJISJE ME AUTORIZIM PER BANORET E ISH – SHKOLLES
SE LIRE USHTARAKE TE NDERMARRJES SE
SHERBIMEVE DHE INVESTIMEVE”.**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës, i mbledhur në dt.24.07.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Ndërtim Strehimit “Për pajisje me autorizim”, mbështetur në Ligjin Nr.7652, dt.23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Lokal”, VKM Nr.49, dt.29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”

VENDOSI

1. Të pajisen me autorizim qytetarët që nuk kanë konflikt :
 - 1.**Hazis Mehmet Kapllani** për (2+1), kati e parë në ish – shkollën e lirë ushtarake të ndërmarrjes së shërbimeve dhe investimeve.
 - 2.**Arian Hysen Turuku** për 1 dhomë në katin e parë në ish – shkollën e lirë ushtarake të ndërmarrjes së shërbimeve dhe investimeve.
 - 3.**Ramazan Sinan Muca** për (2+1), në katin e dytë në ish – shkollën e lirë ushtarake të ndërmarrjes së shërbimeve dhe investimeve.

investimeve.

4.Sefedin Shaban Vrapi për (1+1), në katin e dytë në ish – shkollën e lirë ushtarake të ndërmarrjes së shërbimeve dhe investimeve.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit) për të zbatuar këtë Vendim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI